

**BASHKIA TIRANË**  
**NJOFTIM PËR DHËNIE ME QIRA**

Publikimin në Buletinin e Njoftimeve Publike të procedurës për dhënien me qira me anë të konkurimit të pasurisë me nr. 4/685, lloji i pasurisë Truall, volum 54, faqe 58, ZK.8330, Rruga “Don Bosko”, Tiranë, në pronësi të Bashkisë Tiranë me të dhënat si më poshtë vijon:

- Objekti Truall
- Sipërfaqja 810 m<sup>2</sup>
- Zona Kadastrale 8330
- Çmimi dysheme 81.000 lekë/muaj

2. Pasuria e përcaktuar sipas pikës 1, jepet me qira me qëllim ushtrim aktiviteti tregtar, objekte shërbimi, që përmirësojnë pronën dhe sjellin të ardhura për Bashkinë Tiranë.

3. Afati i dhënies me qira është 20 (njëzetë) vite.

4. Vlerësimi i ofertave të konkurrentëve do të bëhet me pikët si vijon:

- Investimi 50 pikë;
- Punësimi 30 pikë;
- Tarifa mujore e qirasë 20 pikë;

5. Konkurrimi do të zhvillohet më datën 18.06.2020, në orën 12:00, në ambientet e Bashkisë Tiranë.

6. Konkurentët do të paraqesin para komisionit në datën dhe orën e caktuar sipas pikës 5 të këtij urdhëri, dokumentacionin si vijon:

- a) kërkesën e subjektit për marrje me qira të pasurisë shtetërore ku të deklarohet oferta për vlerën e detyrimit mujor të qirasë, qëllimi i marrjes në përdorim të pronës shtetërore si dhe treguesit e konkurimit të parashikuar sipas planit të biznesit
- b) planbiznesin e hollësishëm për vënien në funksionim të objektit, ku të përfshihet informacioni i mëposhtëm:
  - Identiteti i subjektit kërkues, historiku dhe aktiviteti që kryen;
  - Përshkrimi i projektit të investimit, i punimeve që do të realizohen, i shërbimeve që do të ofrohen, i burimeve financiare të investimit;
  - Analiza e detajuar e afateve kohore, që do të duhen për të realizuar projektin investues si dhe fazat e përcaktuara të realizimit të tij;
  - Niveli i punësimit që do të realizohet sipas fazave kohore të përcaktuara
  - Nëse kërkesa e subjektit është për një afat kohor mbi 5 vjet, plani i biznesit të jetë i përshkruar hollësisht, me të dhënat për 5 vitet e para të aktivitetit dhe parashikimin për periudhën tjetër
- c) deklaratat në formën e vetëdeklarimit si më poshtë:
  - Deklaratë për të dhënat e NIPT/NUIS të subjektit kërkues
  - Deklaratë për shlyerjen e detyrimeve tatimore dhe sigurimeve shoqërore
  - Deklaratë për administratorin dhe subjektin juridik ofertues, nëse është në ndjekje penale, si dhe nëse ka procese gjyqësore në lidhje me aktivitetin;
  - Në rast se subjekti konkurrues zhvillon aktivitete me qira në objekte pronë shtetërore, deklaratë për shlyerjen e detyrimeve, në të kundërt të theksojë se nuk ushtron aktivitet në objekte shtetërore;
  - Deklaratë se mban përgjegjësi ligjore për vërtetësinë e deklarimeve në dokumentacionin e dorëzuar në konkurrim.